



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Jashtme – Ministarstvo Inostranih Poslova – Ministry of Foreign Affairs

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG¹

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe FRIEDRICH EBERT STIFTUNG, (këtu e tutje „Palët Nënshkruese“), duke dëshiruar të vendosin dhe të zhvillojnë bashkëpunimin sa i përket hulumtimit të përbashkët dhe trajnimit të stafit diplomatik, kanë arritur këtë marrëveshje:

Neni 1

Qëllimi

Protokolli ka për qëllim të krijojë kushtet për kontakte dhe bashkëpunim të rregullt në fushat arsimore dhe shkencore brenda kornizës së programeve dhe aktiviteteve të Palëve Nënshkruese. Palët Nënshkruese do të fokusohen në prezantimin dhe shtjellimin e metodave moderne për trajnimin e diplomatëve në fushat përkatëse.

Neni 2

Prioritetet

Prioritetet e këtij bashkëpunimi janë:

1. Trajnimi profesional dhe përmirësimi i kualifikimit të diplomave në fushën e:

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

- Politikave të jashtme
- Marrëdhënieve ndërkombëtare
- Integritit Evropian
- Diplomacisë ekonomike
- Sigurisë ndërkombëtare dhe menaxhimit të konfliktit
- Negociatave ndërkombëtare
- Ngritjes së kapaciteteve në trajnimin diplomatik

Neni 3

Zbatimi

Palët nënshkruese do të realizojnë bashkëpunimin nëpërmjet:

1. Programeve të trajnimit bazik dhe të specializuar;
2. Shkëmbimit të diplomatëve, ligjëruesve dhe hulumtuesve/ekspertëve;
3. Shkëmbimit të përvojave mbi aktivitetet relevante arsimore dhe çështjet e metodologjisë së mësimdhënies;
4. Realizimit të projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët;
5. Pjesëmarrjes në konferenca, simpoziume dhe diskutime në panel;
6. Bashkëpunimit në përgatitjen e kualifikimit dhe në punimeve akademike;
7. Shkëmbimit të burimeve arsimore, librave, publikimeve dhe artikujve.

Neni 4

Kushtet financiare

Format, kohëzgjatjet dhe kushtet financiare të shkëmbimit dhe trajnimit të përfaqësuesve të palëve nënshkruese do të dakordohen ndërmjet palëve nënshkruese.

Neni 5

Konferencat, simpoziumet dhe tryezat e rrumbullakëta

Përfaqësuesit e njëres palë mund të marrin pjesë në konferenca, simpoziume dhe tryeza të rrumbullakëta të organizuara nga pala tjetër. Palët Nënshkruese do të informojnë njëra-tjetrën në lidhje me këto ngjarje.

Palët Nënshkruese do të promovojnë organizimin konferencave dhe simpoziumeve të përbashkëta dhe realizimin e projekteve me interes të përbashkët.

Palët Nënshkruese do të bashkëpunojnë në kuadër të kornizës së forumeve dhe organizatave ndërkombëtare ku ato janë të përfaqësuara.

Neni 6

Çështjet me interes të përbashkët

Palët Nënshkruese do të mbështesin organizimin e ligjëratave dhe fjalimeve të ekspertëve nga të dyja palët mbi çështjet me interes të përbashkët.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet dhe kontestet në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve me anë të konsultimeve.

Dispozitat e këtij protokollit mund të ndryshohen me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Memorandumi do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të jetë i vlefshëm, përveç nëse njëra Palë informon Palën tjetër me shkrim për qëllimin e saj për anulimin e këtij memorandumi, së paku tre muaj më herët.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit më poshtë, përmes autorizimit të duhur, kanë nënshkruar këtë memorandum.

E ARRITUR në Prishtinë me ___ të _____2013, në kopje rezerve në gjuhën Angleze, pjese përbërëse e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është Shtojca I e bashkangjitur në këtë memorandum.

Për Akademinë Diplomatike
Republika e Kosovës
[nënshkruar]

Për Friedrich Ebert Stiftung
[nënshkruar]

Albert Prenkaj, Ambasador

Prof. Dr. Wulf Lapins, Shef i Zyrës

Shtojca 1

1. Bashkëfinancimi i Shkollës Pranverore për të Drejtat e Njeriut, Paqen dhe Sigurinë „Gazmend Zajmi“ – bazuar në shembujt e aktiviteteve rajonale të realizuara nga institucionet diplomatike që merren me trajnimin e diplomatëve dhe me përgatitjen e tyre për misione diplomatike, si dhe me organizimin e forumeve rajonale – shkolla do të zgjasë 5 – 7 ditë për zyrtarët nga Kosova dhe institucionet ndërkombëtare, me ligjërues nga Kosova dhe jashtë Kosovës, që merren me çështjet specifike në fushën e të drejtave të njeriut, paqes dhe sigurisë;
2. Hartimi i kurrikulës së Akademisë Diplomatike;
3. Lehtësimi i bashkëpunimit me Institucionet Diplomatike, Akademike dhe jo-qeveritare Gjermane mbi temat e identifikuara nga të dyja palët, që janë subjekt i kësaj Shtojce. Temat e bashkëpunimit janë:
 - Diplomacia e BE-së – një hyrje në dinamikën dhe qasjen gjithëpërfshirëse ndaj kompleksiteteve të punëve të jashtme të BE-së;
 - Punësoria për Ngritjen e Kapaciteteve mbi çështjet e sigurisë ndërkombëtare dhe Evropiane;
 - Të kuptuarit e thelbit të së Drejtës Ndërkombëtare;
 - Negociatat e BE-së në praktikë – zotërimi i artit të negociimit (përmirësimi i aftësive komunikuese dhe negociuese në ndërveprim me institucionet e BE-së dhe brenda tyre);
 - BE-ja në forume multilaterale (analizimi i marrëdhënieve komplekse ndërmjet BE-së dhe organizatave kryesore ndërkombëtare, konferencave dhe grupimeve joformale);
 - Përmirësimi i aftësive për komunikim dhe marrëdhënie me media për diplomaci;
 - Punëtori trajnuese mbi diplomacinë multilaterale mjedisore;
 - Negocimi dhe kryesimi efikas;
 - Punësoria për zhvillimin profesional mbi përmirësimin e performancës në konferenca ndërkombëtare;
4. Shkëmbimi i diplomatëve – një diplomat nga MPJ e Kosovës do të shkon tek MPJ-ja në Gjermani dhe anasjelltas, për të parë praktikën e përditshme në të dyja vendet në baza ditore.